



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 978 prot.

Himarë, më 27.02.2023

**VENDIM**

Nr. 12 datë, 27.02.2023

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 4, DATË 27.01.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK  
PËR BASHKËFINANCIMIN E RESTAURIMIT TË BANESAVE SHUMË TË  
AMORTIZUARA TË FAMILJEVE NË NEVOJË NË ZBATIM TË PROJEKTIT TË  
STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 70, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2023” të Këshillit Bashkiak Himarë. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 27.02.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë e miratoi me shumicë votash dhe si përfundim,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1, të vendimin nr. 4, datë 27.01.2023 të Këshillit Bashkiak, në fund të shtohet: Bazuar në të ardhurat vjetore për frymë për vitin 2021 Bashkia Himarë ka nivelin e të ardhurave mbi 8.000 lekë për frymë dhe kufiri i financimit do të jetë 50% nga bashkia dhe 50% nga Ministria e Financave.
2. Në pikën 2, të shtohet pika 2.1 me përmbajtje si më poshtë:
  - 2.1 Restaurimi i banesave do të realizohet në këto familje në nevojë:
    - a. Panajot Basho në njësinë administrative Horë-Vranisht.
    - b. Salihe Habilaj në njësinë administrative Horë-Vranisht.
    - c. Themistokli Shaha në njësinë administrative Lukovë.
    - d. Stefan Stamo në njësinë administrative Lukovë.
3. Ngarkohet drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e shërbimeve dhe mirëmbajtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vota pro (13), vota kundër (0), vota abstenim (0).

**KRYETARI**  
Dhimitër Kapaj

